

# **NJOFTIMI I MODIFIKIMIT TË KONTRATËS GJATË KOHËZGJATJES SË SAJ**

## **AUTORITETI PORTUAL DURRËS**

NJOFTIMI PËR MODIFIKIMIN E MARRËVESHJES KUADËR/KONTRATËS GJATË  
ZBATIMIT

1. Emri dhe adresa e Autoritetit Kontraktor

Emri Autoriteti Portual Durrës

Adresa Lagja 1, Rruga Tregtare, Durrës

Tel/Faks 052293402

E-mail info@durresport.al

Ueb-faqe www.durresport.al

2. Kontaktet e personit (ave) përgjegjës për prokurimin:

Emri: S.Mece

E-mail: s.mece@durresport.al

3. Lloji i procedurës së prokurimit: e Hapur e Thjeshtuar – shërbim (Me mjete elektronike)

4. Lloji i kontratës / Marrëveshjes kuader: Kontrate

5. Numri i referencës për procedurën / Lotin: REF-07021-10-01-2021

6. Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër: “Shërbim Telefoni dhe Internet për 2 vjet”

7. Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP):

Shërbime të telekomunikacionit 64200000-8; Shërbimet e internetit 72400000-4

8. Fondi limit: 3.072.660 (tre milion e shtatëdhjetë e dy mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë) leke pa tvsh.

9. Situata sipas parashikimeve të nenit 127 të LPP dhe argumentet përkatëse për ta përdorur atë:

Mbështetur në nenin 127, pika 1/c, të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” dhe në nenin 23, pika 2, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, ky modifikim është bërë i nevojshëm për shkak të rrethanave të paparashikueshme nga AK dhe që nuk ndryshojnë në thelb natyrën e kontratës së prokurimit me objekt “Shërbim Telefoni dhe Internet për 2 vjet”, me Nr. REF-07021-10-01-2021.

Gjatë datës 22/09/2023, u evidentua se drejt firewallit të Autoritetit Portual Durrës kishte trafik mbi normalen me një numër të lartë kërkesash drejt website www.durresport.al. Nga evidentimi i kryer rezultoi se po kryhej sulm “DDOS” drejt website. Duke qenë se pajisja firewall ASA5515 nuk përballon këtë kategori trafiku dhe nuk ka detektim dhe mbrojtje për DDOS, nga AKCESK dhe

AKEP na sugjeroi ndryshimin e IP dhe kalimi i tyre në zonë të mbrojtur nga ISP. Në bashkëpunim me AKCESK, AKEP dhe kompaninë ISP (One) që ofron shërbimin drejt Autoritetit Portual Durrës u bë e mundur ndryshimi i IP publike 79[.]106[.]171[.]146 duke qenë se ishte në një zonë të pa mbrojtur publike. Nga ISP u kalua në tjetër rang IP ku webserver kaloi në IP 79[.]106[.]42[.]25 , në një zonë të mbrojtur nga pajisjet firewall të ISP. U krye ndryshimi përkatës i Name Server në Cloudflare me AKEP dhe u krye maskim i IP sërisht në Cloudflare. Aktualisht rangi i APD është tek IP 79[.]106[.]42[.]25 – 30. Ky shërbim u ofrua pa pagesë, përkohësisht deri në stabilizimin e situatës, nga operatori ekonomik One Communication, me të cilin Autoriteti Portual ka lidhur një kontratë me Nr. 244 Prot., datë 25/01/2022, me objekt “Shërbim Telefoni dhe Internet për 2 vjet” Bazuar në rekomandimet e AKCESK një ndër masat që duhet të marrim si Autoritet është: Implementimi i filtrave Network DDoS Protection, Application DDoS Protection, Website DDoS Protection. Firewall që aktualisht kemi në përdorim nuk na i ofron këto lloj filtrash dhe DDoS Protection.

Për sa më lart argumentuar, paraqitet nevoja për amendimin e kontratës fillestare, duke u ndryshuar afati i zbatimit dhe vlera totale e kontratës së prokurimit në fjalë. Vlera e amendimit nuk tejkalon masën prej 20% të vlerës së kontratës fillestare.

I gjithë dokumentacioni, ku përfshihen komunikimet ndër-institucionale, relacionet dhe argumentimet teknike përkatëse, janë pjesë e dosjes së prokurimit me Nr. REF-07021-10-01-2021.

10. Përshkrimi i modifikimit të kontratës/Marrëveshjes Kuadër, përfshirë natyrën dhe sasinë ose vlerën e mallrave:

Amendimi i kontratës së prokurimit në vlerën 20% të vlerës së kontratës fillestare (në shumën prej 359.000 (treqind e pesëdhjetë e nëntë mijë )lekë pa tvsh) për periudhën nga nënshkrimi i amendamentit ndërmjet palëve deri në përfundimin të afatit të kontratës fillestare.

Të gjitha kushtet, të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në Kontratën e firmosur më 25.01.2022 me Nr. Prot. 244, me objekt “Shërbim Telefoni dhe Internet për 2 vjet”, mbeten të pandryshuara dhe janë të vlefshme dhe për këtë amendament kontrate.

Ky Amendament Kontrate bëhet pjesë integrale e kontrates se sipercituar.

11.Vlera totale e kontratës së nënshkruar/marrëveshjes kuadër:

Çmimi i kontratës me tvsh, në lekë ishte: 2.154.000 (dy milion e njëqind e pesëdhjetë e katër mijë ) lekë

12. Vlera e ndryshuar (nëse është rasti):

Çmimi i kontratës me tvsh në Lekë, bëhet: 2,584,800 (dy milion e pesëqind e tetëdhjetë e katër mijë e tetëqind)

13. Emri dhe adresa e operatorit/ëve Ekonomikë:

Emri: ONE ALBANIA - NIPT J61814094W

Rr. "Muhedin Llagami", Kompleksi Square 21, TIRANE

Web site: www.one.al

E-Mail: contactus@one.al

Telefon: 042275300